



Komiteti për Politikë dhe Financa

01.Nr.I

Deçan, dt.26.01.2021

### PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e I-rë të rregullt të KPF-së, me dt.26.01.2021.

Në mbledhje merrnin pjesë: 5 anëtar të KPF-së (mungojnë me arsye Albesa Cacaj dhe Natyra Kuçi), Drejtori Urbanizmit-Ramë Melaj, Kryesuesi i Komitetit të Komuniteteve-Elmir Nezaj, Udhëheqësi i ZLK-së-Shaban Pejçinoviç, Zyrtarja për informim-Yllarta Thaqi. Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2021,
3. Shqyrtimi i propozimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2021,
4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komitetit të Komuniteteve për vitin 2021,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Zyrës për komunitete dhe Kthim dhe Integritet Evropian për vitin 2021,
6. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për Pëlqimin Mjedisorë për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisorë të PZHK-së,
7. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës,
8. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Deçanit,
9. Shqyrtimi i Planit të Integritetit,
10. Shqyrtimi i Raportit të Përformancës për vitin 2019,
11. Shqyrtimi i Planit të Veprimit kundër korrupsionit,
12. Shqyrtimi i kërkesave,
13. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Miratohet njëzëri pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2021.

Rekomandim:nga antarët e KPF-së u vlerësua si plan i mirë, planin si të tillë e dërgojnë në Asamble për shqyrtim dhe miratim.

3. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2021.

Rekomandim: Propozim Vendimi përcillet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend pa ndryshime.

4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komitetit të Komuniteteve për vitin 2021.

Kryesuesi- e ka prezentu këtë pike pastaj fjalën ia ka dhënë Kryesuesit të Komitetit të Komuniteteve, z.Elmir Nezaj- i cili ka thënë se ky është plani jonë për vitin 2021, shpresojmë që ta zbatojmë dhe të shqyrtojmë edhe tema tjera sipas kërkesës dhe nevojës. Mon Selmonaj- thotë se kishte qene mire qe ne plan te planifikohet edhe raporti i punës së komitetit.

Kryesuesi i kuvendit- kërkon nga kryesuesi i komitetit që të merr pjesë në mbledhjet e kuvendit, për të cilën gjë është pajtuar kryesuesi i komitetit, z.Elmir Nezaj.

Rekomandim:KPF e kanë shqyrtuar Planin e punës së Komitetit të Komuniteteve për vitin 2021 dhe të njëjtin e përcjellin në Kuvend me propozimin që të parashihet në plan edhe raporti i punës së komitetit.

5. Shqyrtimi i Planit të punës së Zyrës për komunitete dhe Kthim dhe Integritet Evropiane për vitin 2021.

Rekomandim: KPF e shqyrtuan këtë pike, e vlerësuan si një plan të mirë dhe si të tillë pa ndryshime e përcjellin në kuvend për miratim.

6. Marrja e vendimit për Pëlqimin Mjedisorë për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisorë të PZHK-së.

Kryesuesi- e ka prezentu këtë pike pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm, z.Ramë Melaj, i cili ka sqaruar se është njeri prej dokumenteve të cilat duhet të miratohen paraprakisht në mënyrë që të kemi mundësi me vazhdu me procedura deri të miratimi i PZHK-së.

Rekomandim: Pas shqyrtimit të kësaj pike dhe sqarimeve të dhëna nga drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, KPF e përcjellin propozimin për kuvend për shqyrtim dhe marrje të vendimit.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Rekomandim-Vlerësohet si rregullore e mirë dhe përcillet për shqyrtim dhe miratim në kuvend pa ndryshime.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Deçanit.

Rekomandim:KPF e përcjellin në kuvend pa ndryshime, po ashtu edhe nga debati publik nuk ka ndonjë propozim për ndryshim.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Integritetit.

Rekomandim: KPF edhe këtë pike e përcjellin në kuvend pa ndryshime, për të njëjtën edhe nga debati publik nuk ka propozim për ndryshim.

10. Shqyrtimi i Raportit të Përformancës për vitin 2019.

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj ka shtuar se nuk është në dijeni se në çfarë kritere janë bazuar kur është nxjerrë ky raport mirëpo sa i përket shëndetësisë janë shifra të pasakta që nuk e prezantojnë gjendjen reale të ne, në vazhdim fjalën ia kalon zyrtarit komunal njeherit Koordinator për performancë të komunës, z.Xhevat Lufaj, i cili ka thënë se raporti është ky të cilin e keni ju ndërsa për sqarime jam i gatshëm në pyetjet e juaja.

Mon Selmonaj-thotë se për këto të dhëna të prezantuara kemi vërejtje dhe kërkoj sqarim ku janë marrë të dhënat e prezantuara, pyetjet e tij kanë qenë rreth të dhënave për ujin e pijes,



...nëna dhe te pjesë të ngjantueshme, sqarim të ndërmarrja Higjiena, të kultura, të barazia në punësim, të kanalizimi i ujërave të zeza, të gjendja në shëndetësi, për të cilat ka dhënë sqarime, z.Xhevat Lufaj, person përgjegjës i komunës, mirëpo është kërkuar që në kuvend të ftohen Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, z.Musa Berisha dhe Drejtori i QKMF-se, z.Selman Berisha, që të vijin mbledhjen e Kuvendit të dt.29.01.2021 dhe të japin sqarime rreth të gjitha punëve që kanë të bëjnë me shëndetësinë në Komunë, të prezentuara me shifra në raportin e përformancës.

Valdet Nuraj- në diskutimin e tij është ndalur te kultura e cila nuk funksionon dhe vlerësimet për mua ka thënë ai janë ta pasakta.

Xhevat Lufaj- sqaron se të gjitha të dhënat futen në raport sipas kritereve të prezentuara në një formular nga MAPL, të cilat na kanë qite këtë rezultat, në bazë të treguesve të përcaktuar nga Ministria.

Rekomandim:KPF e shqyrtuan këtë pike dhe i drejtuan një varg pyetjesh zyrtarit përgjegjës të Komunës, të cilat në të njëjtën kohë ishin edhe si vërejtje për raportin e prezentuar, pyetjet kanë qenë rreth të dhënave për ujin e pijes, të ndërmarrja Higjiena, të kultura, të barazia në punësim, të kanalizimi i ujërave të zeza, të gjendja në shëndetësi, për të cilat ka dhënë sqarime, z.Xhevat Lufaj, person përgjegjës i komunës, mirëpo është kërkuar që në kuvend të ftohen Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, z.Musa Berisha dhe Drejtori i QKMF-se, z.Selman Berisha, që të vijin mbledhjen e Kuvendit të dt.29.01.2021 dhe të japin sqarime rreth të gjitha punëve që kanë të bëjnë me shëndetësinë në Komunë, të prezentuara me shifra në raportin e përformancës.

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit kundër korrupsionit.

Rekomandim: KPF e përcjellin në kuvend pa ndryshime për shqyrtim dhe miratim.

12. Shqyrtimi i kërkesave .


1.Kërkesa e mjekëve dhe infermiereve për pagesë për punën shtesë gjatë kohës së pandemisë për muajt: Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020.

KPF kanë shqyrtuar edhe kërkesën financiare për pagesën e gjithë punëtorëve shëndetësorë(mjekë dhe infermier) të cilët kanë punuar gjatë kohës së pandemisë covid 19 dhe nuk janë përfshi në pakon qeveritare sepse nuk janë në liste të pagave sepse janë të punësuar me kontratë me kushte të veçanta. Pagesa kërkohet të bëhet për muajt Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020, sipas listës së prezentuar nga QKMF dhe datave të punësimit, mirëpo meqenëse vlera mbi 5000€ kërkon që vendimi të merret në Kuvend, KPF i rekomandojnë Kuvendit për miratimin e kësaj kërkesë, llogaritja do të bëhet sipas listës së mjekëve dhe infermierëve, shuma e kërkuar është 7550,00 €.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lllolluni



Verifikon procesverbalin



Kryesuesi i KPF-së  
Haki Shehaj

